

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

SHËRBIME DETARE NË KUVERTË

Niveli V në KSHK¹, referuar nivelit V të KEK²

J1-V-14

Ky Përshkrim Kualifikimi Profesional u hartua me mbështetjen e Projektit IPA 2010 për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, financuar nga Bashkimi European dhe zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës



Projekt i financuar
nga Bashkimi
European



Projekt zbatuar nga
Organizata
Ndërkombëtare e
Punës

Tiranë, Shtator 2014

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	SHËRBIME DETARE NË KUVERTË			Kodi
Kohëzgjatja	900-1000 orë	Niveli	V në KSHK, referuar nivelit V të KEK	J1-V-14
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Shërbime detare në kuvertë” niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, është të aftësojë individët me praktikat bazë të punës në bordin e një mjeti lundrues si në det, ashtu edhe gjatë operacioneve në port, përfshirë parimet e sigurimit teknik dhe aftësi komunikuese në mjetin lundrues, mbijetesën në det, parandalimi dhe lufta ndaj zjarrit, dhënien e ndihmës së parë, ruajtjen e mjedisit dhe sigurinë portuale, për t’u punësuar në industrinë detare.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në ofruesit e kualifikimeve profesionale në “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë, niveli IV, referuar nivelit IV të KEK; - janë në kushte shëndetësore për punë në det, sipas kërkesave të Ligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët” STCW 1978 dhe amendamentet e mëvonshme. - janë të aftë të notojnë - janë të aftë të komunikojnë në gjuhën angleze 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, e pajis individin me Certifikatën e aftësisimit profesional Rregulli II/4 i STCW³ + Rregulli III/1 i STCWF⁴ si dhe: Pas një përvoje të përcaktuar nga Administrata Detare fiton të drejtën të pajiset me Certifikatën e aftësisimit profesional si Marinar Kuverte i Kualifikuar Rregulli II/5 i STCW + Rregulli II/4 i STCWF</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me ndjekjen e një Kualifikimi të lartë të caktuar në fushën e detarisë fiton të drejtën të pajiset me Diplomën në Navigacion me mundësi karriere si: <ul style="list-style-type: none"> a. Oficer Kuverte, b. Oficer i II, c. Oficer i I, dhe d. Kapiten sipas Rregullave përkatëse të Administratës Detare, STCW dhe STCWF. <p>Ky kualifikim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në mjetet e lundrimit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Peshkimi bregdetar deri në 20 milje nga bregu më i afërt 2. Peshkimi apo argëtimi - çlodhje në ujërat e brendshme 3. Shërbimi portual 4. Transporti detar ndërkombëtar 5. Roje bregdetare dhe agjencive të tjera ligj-zbatuese në det 6. Kërkimore shkencore dhe praktike mësimore 			

³ Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Atestimit të Detarëve

⁴ Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Atestimit të Peshkatarëve

	7. Argëtimi - çlodhje në det 8. Platforma fikse në det.
Data e validimit	
Data e miratimit	
Variantet e mëparshme	Nuk ka

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Industria detare

- Të përshkruajë portet, parimet e organizimit dhe veprimtaritë kryesore;
- Të përshkruajë llojet e ndryshme të aktiviteteve ekonomike në industrinë e transportit detar;
- Të përshkruajë historinë veprimtarive detare në vendin tonë;
- Të përkufizojë parimet kryesore të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në industrinë e transportit detar & peshkimit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar në fushën e detarisë;
- Të përshkruajë elementet kryesore të legjislacioni e aplikueshëm të punës në det;
- Të listojë institucionet në fushën e detarisë dhe funksionet përkatëse të tyre;
- Të përshkruajë konceptet bazë të hidrometeorologjisë;
- Të dallojë aparatet kryesore të matjes së elementeve hidrometeorologjikë në mjetin lundrues;

Konstruksioni i Mjetit Lundrues

- Të identifikojë tipet e mjeteve lundruese;
- Të dallojë pjesët kryesore përbërëse të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë funksionet e mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës;
- Të përshkruajë mënyrat e përdorimit të mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës;

Veglat dhe Mjetet e Punës

- Të identifikojë veglat dhe mjetet e punës;
- Të përshkruajë funksionet e veglave dhe mjeteve të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të veglave dhe mjeteve të punës;

- Të përshkruajë metodat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të punës;

Mirëmbajtja

- Të rendisë hapat e punës për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të kuvertës;
- Të shpjegojë metodat e ruajtjes së mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës;
- Të shpjegojë metodat mirëmbajtjes së mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës;
- Të radhisë hapat e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të omergjimit;
- Të përshkruajë hapat e punës për mirëmbajtjen e hapësirave të ngarkesës;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen për mjetet e Mbrojtjes Kundra Zjarrit;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen për mjetet e shpëtimit;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen në sektorin e akomodimit;

Aktiviteti i Mjetit Lundrues në Port

- Të dallojë терминалет portuale, funksionet dhe pjesët përbërëse të tyre;
- Të radhisë hapat e punës për përgatitjen e mjetit lundrues për ngarkim/shkarkim;
- Të rendisë veprimet për kontrollin e fiksimit të sigurtë të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë veprimet për përgatitjen e mekanizmave të përpunimit të ngarkesës të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e ngarkesës për lundrim;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e hapësirave të ngarkesës për lundrim;
- Të radhisë veprimet për sigurimin e mekanizmave të përpunimit të ngarkesës për lundrim;
- Të radhisë veprimet për sigurimin e agregateve dhe materialeve të lëvizshme në kuvertë për lundrim;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e hermetizimit të hapësirave në mbistrukturë për lundrim;
- Të përshkruajë veprimet për përgatitjen e mjeteve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit;
- Të përshkruajë punën për evidentimin e ngarkesës që ngarkohet ose shkarkohet nga mjeti lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës për përgatitjen e akostim/ç’akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës që kryhen gjatë akostim/ç’akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës që kryhen pas akostim/ç’akostimit të mjetit lundrues;

Aktiviteti i Mjetit Lundrues në Det

- Të dallojë drejtimit kryesore të horizontit;
- Të listojë mjetet dhe aparaturat kryesore në urën e komandës dhe funksionet përkatëse të tyre;
- Të interpretojë aparaturat përkatëse për identifikimin e drejtimeve të lëvizjes së mjetit lundrues në det;
- Të përshkruajë veprimet që kryhen gjatë shërbimit në urën e komandës;
- Të rendisë veprimet që kryhen në patrullimin periodik në mbistrukturë;
- Të përshkruajë veprimet që kryhen për kontrollin e gjendjes së ngarkesës gjatë lundrimit;
- Të përshkruajë veprimet që kryhen për kontrollin e hapësirave të ngarkesës gjatë

lundrimit;

- Të radhisë hapat e punës për përgatitjen për hedhjen/ngritjen e spirancës të mjetit lundrues;
- Të radhisë veprimet që kryhen gjatë hedhjes/ngritjes së spirancës të mjetit lundrues;
- Të radhisë veprimet që kryhen pas hedhjes/ngritjes së spirancës të mjetit lundrues;

Peshkim

- Të përshkruajë teknikat kryesore të gjuetisë së peshkut;
- Të identifikojë llojet e veglave kryesore të peshkimit dhe pjesët përbërëse të tyre;
- Të përshkruajë veprimet për përgatitjen e materialeve dhe veglave për peshkim;
- Të përshkruajë radhën e punës për hedhjen në ujë dhe marrjen nga uji të veglave të peshkimit;
- Të identifikojë llojet kryesore dhe cilësitë e produkteve të zëna nga gjuetia;
- Të përshkruajë kushtet e duhura për ruajtjen e freskisë së produkteve të zëna nga gjuetia;

Avaritë e mundshme në Mjetin Lundrues

- Të rendisë masat e sigurimit teknik për punime në hapësira të mbyllura;
- Të rendisë masat e sigurimit teknik për punime jashtë bordit;
- Të rendisë masat e sigurimit teknik për punime në temperatura të larta;
- Të rendisë masat e sigurimit teknik për punime elektrike;
- Të rendisë masat e sigurimit teknik për punime nën ujë;
- Të rendisë veprimet për braktisjen e mjetit lundrues;
- Të listojë mjetet dhe veshjet për mbijetesën në det;
- Të përshkruajë praktikën për mbijetesën në det;
- Të identifikojë llojet e pajisjeve për dhënien e sinjalit të fatkeqësisë;
- Të radhisë mjetet dhe veshjet për mbrojtjen kundra zjarrit;
- Të përshkruajë veprimet për luftën kundra zjarrit;
- Të rendisë hapat e punës për luftën kundra ujit;
- Të listojë llojet e ndotësve të mjedisit detar;
- Të radhisë masat për parandalimin e ndotjeve të mjedisit detar;
- Të listojë inventarin e materialeve për reagim ndaj ndotjeve detare;
- Të përshkruajë veprimet për reagimin gjatë ndotjeve të mjedisit detar;
- Të përshkruajë veprimet për dhënien e ndihmës së parë;
- Të përshkruajë veprimet për operacione me helikopter;
- Të radhisë veprimet për shpëtimin e njeriut të rënë në det;
- Të listojë masat mbrojtëse kundër piraterisë;
- Të përshkruajë veprimet për reagim ndaj terroristëve dhe sabotuesve;
- Të radhisë hapat e punës për rimorkimin e mjetit të lundrimit;
- Të identifikojë veshjet dhe mjetet e mbrojtjes personale në punë;
- Të përshkruajë parimet kryesore të mospërdorimit të substancave të dëmshme (drogë dhe alkool) në mjetin e lundrimit.

Komunikimi me të tjerët

- Të interpretojë terminologjinë standarde detare ndërkombëtare në gjuhë amtare dhe

anglisht;

- Të interpretojë sinjalet e alarmeve në mjetin lundrues;
- Të interpretojë sinjalet kryesore sipas REPAD5;
- Të interpretojë sinjalet kryesore sipas Kodit Ndërkombëtar të Sinjaleve;
- Të interpretojë sinjalet e dorës sipas Kodit të Praktikës së Sigurtë të Punës në Porte sipas ILO6-s;
- Të interpretojë veprimet që duhen kryer kur i jepet një urdhër i dhënë nga eprori;
- Të përshkruajë rregullat dhe etikën e komunikimit në mjetin lundrues;
- Të dallojë simbolet kryesore të mallrave të rrezikshme;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Industria detare

- Të zbatojë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në industrinë e transportit detar & peshkimit;
- Të zbatojë elementet kryesore të legjislacioni e aplikueshëm të punës në det;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar në fushën e detarisë;
- Të interpretojë leximet e aparateve kryesore të matjes së elementeve hidrometeorologjike në mjetin e lundrimit (termometër, barometër, hygrometër, anemometër, etj.);

Konstruksioni i Mjetit Lundrues (Mekanizmat)

- Të përdorë vinçin e spirancës;
- Të përdorë vinçat e akostim/ç'akostimit;
- Të përdorë mekanizmin e hapje-mbylljes së hapësirave të ngarkesës;
- Të realizojë mbylljen hermetike të hapjeve të ndryshme në kuvertë;
- Të armatisë dhe ç'armatisë shkallën e imbarkimit (trapin);

Veglat dhe Mjetet e Punës

- Të kryejë nyjet (lidhjet) kryesore detare me cima;
- Të realizojë gacat me cima dhe me kavo;
- Të kryejë qepjen e cimës dhe të kavos;
- Të mbështesë oficerin e kuvertës për matjen e tankeve;
- Të përgatisë skelën për punime jashtë bordit dhe në lartësi;
- Të realizojë kalimin e cimave dhe të kavove në parango dhe makarà;

Mirëmbajtja

- Të lubrifikojë mjetet, mekanizmat dhe agregatet në sektorin e kuvertës;
- Të kryejë mirëmbajtjen e sipërfaqeve të kuvertës;
- Të kryejë mirëmbajtjen hapësirat e ngarkesës;

⁵ REPAD – Rregullore e Evitimit të Përplasjeve të Anijeve në Det

⁶ ILO- International Labour Organization – Organizata Ndërkombëtare e Punës;

- Të kryejë mirëmbajtjen e mjeteve të Mbrojtjes Kundra Zjarrit;
- Të kryejë mirëmbajtjen e mjeteve të shpëtimit;
- Të mirëmbajë sektorin e akomodimit;
-

Aktiviteti i Mjetit Lundruës në Port

- Të realizojë në grup hapje-mbylljen e hapësirave të ngarkesës;
- Të realizojë vendosjen dhe heqjen e mjeteve mbrojtëse të skafit të mjetit lundruës;
- Të operojë me cimat për fiksimin e sigurtë të mjetit lundruës;
- Të mbështetë operatorin e mekanizmave të përpunimit të ngarkesës;
- Të realizojë bragimin e ngarkesës për lundrim;
- Të kashtanojë kapakët e hapësirave të ngarkesës për lundrim;
- Të sigurojë agregatet dhe materialet e lëvizshme në kuvertë për lundrim;
- Të realizojë vendosjen e sigurtë të mjeteve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit;
- Të plotësojë një raport spontimi të ngarkesës që ngarkohet ose shkarkohet nga mjete lundruës;
- Të realizojë dhënien dhe marrjen e cimave për akostim/ç'akostimin e mjetit lundruës;

Aktiviteti i Mjetit Lundruës në Det

- Të manovrojë me timonin sipas komandës së dhënë;
- Të identifikojë drejtimet e lëvizjes së mjetit lundruës në det;
- Të identifikojë këndet kursore të objekteve që janë përreth mjetit lundruës;
- Të raportojë objektet dhe dinamikën e tyre, që sheh dhe dëgjon nga vëzhgimi përreth mjetit lundruës;
- Të kryejë një patrullim në mbistrukturë/hapësirat e ngarkesës gjatë lundrimit;
- Të kryejë hedhjen/ngritjen e spirancës së mjetit lundruës;

Peshkim

- Të përgatisë materialet dhe veglat për peshkim;
- Të përdorë vinçin e tratës dhe të veglave të peshkimit;
- Të kryejë në bashkëpunim me të tjerë hedhjen në ujë dhe marrjen nga uji të veglave të peshkimit;
- Të seleksionojë produktin e zënë nga gjuetia sipas llojit dhe cilësisë;
- Të realizojë ruajtjen e freskisë së produkteve të zëna nga gjuetia;

Avaritë e mundshme në Mjetin Lundruës

- Të notojë në kushte të ndryshme në ujë;
- Të vozisë barkë mbijetese;
- Të veshë xhaketën e shpëtimit;
- Të veshë kostumin termik;
- Të veshë kostumin për luftën kundra zjarrit;
- Të veshë brezin e ruajtjes për punime në lartësi;
- Të veshë pajimet personale të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të përdorë Pajisjen e Frymëmarrjes për Largim Emergjence (EEBD);
- Të reagojë në rast dhënies së sinjaleve të alarmit sipas procedurës së manualit në mjetin

lundruës (SOLAS⁷);

- Të lëshojë, në grup, trapin pneumatik në ujë;
- Të punojë në grup për hedhjen e barkës së mbijetesës në det;
- Të punojë në grup për lëshimin dhe marrjen e barkës së shpëtimit;
- Të përdorë teknikat dhe mjetet në barkën e mbijetesës në det;
- Të reagojë në rastet e rënies së njeriut në det në përputhje me manualin e trajnimit të mjetit lundruës;
- Të aktivizojë pompën zjarrfikëse të emergjencës;
- Të përdorë mjetet dhe sistemet për fikjen e llojeve të ndryshme të zjarrit në mjetin lundruës;
- Të përdorë mjetet dhe veglat për luftën kundra ujit në mjetin lundruës;
- Të japë ndihmën e parë;
- Të transportojë një person të lënduar;
- Të realizojë kthimin mbarë të trapit pneumatik në ujë kur është i përmbysur;
- Të ndajë mbetjet e ngurta sipas kategorive;
- Të përdorë materialet për reagim ndaj ndotjeve detare;
- Të përdorë mjetet dhe teknikat për operacionet me helikopter;
- Të përdorë mjetet për rimorkimin e mjetit të lundrimit;
- Të realizojë detyrat e ngarkuara sipas Planit të Sigurisë së Mjetit të Lundrimit;

Komunikimi me të tjerët

- Të përdorë terminologjinë standarde detare ndërkombëtare në shqip dhe anglisht;
- Të përdorë pajisjet për dhënien e sinjalit të alarmit;
- Të përdorë radion e dorës për raportime;
- Të përdorë sistemet e brendshme të komunikimit në mjet lundrimi;
- Të përdorë sinjalet e dorës sipas Kodit të Praktikës së Sigurtë të punës në Porte sipas ILO;
- Të kuptojë urdhrat dhe të komunikojë me eprorin për çështje që kanë lidhje me detyrat e dhëna;
- Të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e komunikimit me të tretët.
-

I. KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më

⁷ SOLAS – Safety of Life at Sea – Shpëtimin e Jetës në Det

efektive dhe më efçiente;

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.